



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA KOMBËTARE E  
KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

Nr. 59 prot.

Tiranë, më 30.01. 2025

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. 190 prot.

Tiranë, më 30.01. 2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

**DHE**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**PËR**

**SHKËMBIM INFORMACIONI NË KUADËR TË KONTROLLIT, INSPEKTIMIT  
DHE MONITORIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË  
CANNABIS-IT**

Sot, në Tiranë, më datë 30.1.2025, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis:

**Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it**, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, Prof. Ass. Linda PUSTINA, këtu e në vijim “*Agjencia*”

dhe

**Prokuroria e Përgjithshme** përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm z. Olsian ÇELA, këtu e në vijim “*Prokuroria*”

**Duke u mbështetur** në ligjin nr.61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllim mjekësore dhe industriale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ligjin nr.97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjin “Për mbrojtjen e të dhënavë personale”,

bien dakord për të nënshkruar këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, këtu e në vijim “*Marrëveshje*”:

**Neni 1  
Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i mënyrës së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes Agjencisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme për të siguruar zbatimin korrekt të ligjit që lidhet me kontrollin dhe përdorimin e *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të tij për qëllime mjekësore dhe industriale, ndjekjen penale të shkeljeve që përbëjnë vepër penale, si dhe çështje të tjera me interes të përbashkët.

**Neni 2  
Fushat e bashkëpunimit**

Palët synojnë të bashkëpunojnë për të siguruar zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve që lindin nga ligji për kontrollin e kultivimit, prodhimit dhe qarkullimit të bimës së *cannabis-it*, nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare për përdorim mjekësor dhe industrial lidhur me:

- a) hetimin dhe ndjekjen penale në rast të shkeljes së ligjit që lidhet me përdorimin e *cannabis-it* për qëllime mjekësore dhe industriale në mënyrë të paligjshme;
- b) shkëmbimin e informacionit për veprimtaritë e paligjshme të lidhura me kultivimin, prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e *cannabis-it* për qëllime mjekësore dhe industriale.
- c) për verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatit/punonjësit të Agjencisë ose subjekteve të licencuara/lejuara, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- ç) organizimin e programeve të përbashkëta për trajnimin e stafit dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e cannabis-it;
- d) kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim që veprimtaritë që lidhen me bimën e cannabis-it të janë brenda kuadrit ligor dhe të parandalohet veprimtaria kriminale;
- dh) pjesëmarrjen në projekte apo trajnime të përbashkëta me interes dypalësh në kuadër të objektivave institucionale.

**Neni 3**  
**Mjetet e bashkëpunimit**

1. Palët bashkëpunojnë me të gjitha format e konsultimit, të informimit dhe të ofrimit të mbështetjes.
2. Bashkëpunimi në kuadër të kësaj marrëveshjeje në parim do të realizohet përmes shkëmbimit të informacionit në formë shkresore.
3. Zbatimi nga secila palë e kësaj marrëveshje bashkëpunimi do t'i nënshtrohet rregullave, udhëzimeve, politikave dhe procedurave përkatëse të secilës palë.
4. Palët bien dakord të krijojnë një Grup Koordinues të Përbashkët, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të Agjencisë dhe Prokurorisë, për të mbajtur takime periodike dhe për të diskutuar përparimet dhe sfidat në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
5. Palët do të përdorin kanale të sigurta për shkëmbimin e informacionit.

**Neni 4**  
**Angazhimet e Prokurorisë**

1. Prokuroria angazhohet të ofrojë informacion sipas kërkesës së Agjencisë për verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatit/punonjësit të Agjencisë.
2. Prokuroria angazhohet të ofrojë informacion sipas nevojës dhe fushës së veprimtarisë për punonjësit e subjekteve të licencuara/lejuara ku përfshihen pronarët/aksionarët, administratorët dhe punonjësit të cilët janë pjesë e procesit të verifikimit të kryer nga Agjencia.
3. Prokuroria angazhohet që me kërkesë të Agjencisë të japë informacion për çdo kallëzim ose hetim të filluar për punonjësit e Agjencisë ose subjektet e licencuara, duke respektuar sekretin hetimor.
4. Prokuroria angazhohet të informojë Agjencinë në përputhje me dispozitat procedurale penale në rastet kur ka bërë kallëzim penal.
5. Prokuroria angazhohet të sigurojë bashkëpunim në procesin e organizimit të trajnimeve/aktiviteteve të përbashkëta me interes dypalësh.

**Neni 5**  
**Angazhimet e Agjencisë**

1. Agjencia angazhohet të përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme dokumentacionin e plotë lidhur me kërkesën për verifikimin e kandidatëve/punonjësve të Agjencisë dhe të subjekteve të licencuara/lejuara.
2. Agjencia njofton Prokurorinë e Përgjithshme në rast konstatimi të shkeljes së ligjit për përdorimin në mënyrë të paligjshme të *cannabis*-it. Në rastet kur Agjencia bën kallëzim penal në prokurorinë kompetente, materiali përveç kërkesave të parashikuara në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të shoqërohet edhe me një relacion përbledhës të faktit të konstatuar ku të shënohen elementët e veprës/veprave penale, shkeljet e akteve ligjore e nënligjore dhe pasojat e ardhura, me raporte kontrolli, inspektimi, monitorimi, si dhe çdo dokument tjetër të hartuar nga punonjësit e saj në lidhje me faktin e kallëzuar dhe të referuar si vepër penale dhe që vlerësohet i nevojshëm për hetimin dhe zbulimin e veprës/veprave penale dhe autorëve të tyre.
3. Agjencia ofron bashkëpunimin e saj në vendosjen në dispozicion të provave dhe ekspertizës teknike për hetime dhe ndjekje penale.
4. Agjencia angazhohet të ketë komunikim periodik me Prokurorinë.
5. Agjencia mbron në çdo situatë sigurinë e veprimtarisë së saj, të informacionit dhe të punonjësve, duke ndaluar në çdo rast eksposimin e paautorizuar të informacionit sipas klasifikimit.
6. Agjencia angazhohet të sigurojë bashkëpunim në procesin e organizimit të trajnimeve/aktiviteteve të përbashkëta me interes dypalësh.

#### **Neni 6 Angazhimet e përbashkëta**

1. Palët angazhohen të marrin të gjitha masat e nevojshme administrative, teknike dhe logjistike për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët angazhohen të zhvillojnë një plan të përbashkët komunikimi dhe raportimi.
3. Palët angazhohen të ruajnë të gjitha informacionet e shkëmbryera ndërmjet tyre që përbajnë të dhëna konfidenciale, të cilat do të konsiderohen të mbrojtura në çdo rrethanë, duke respektuar privatësinë dhe integritetin e informacionit të ruajtur.

#### **Neni 7 Konfidencialiteti**

1. Të dhënat personale dhe të dhënat e administruara në kuadër të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës së kandidatëve/punonjësve të Agjencisë dhe subjekteve, konsiderohen konfidenciale në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
2. Palët kanë të drejtë të kërkojnë që përbajtja e kësaj Marrëveshje dhe të dhënat personale të pjesëmarrësve në aktivitetet e përbashkëta dhe të gjitha informacionet e shkëmbryera, të ruhen dhe trajtohen si konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Detyrimet e mësipërme për ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidentialitetit të të dhënave, shtrihen edhe mbi nëpunësit e palëve, gjatë dhe pas përfundimit të Marrëveshjes.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Ndryshime të kësaj marrëveshje mund të bëhen vetëm më dakordësinë me shkrim të të dyja palëve.

**Neni 9**  
**Pikat e kontaktit**

1. Palët caktojnë dhe i komunikojnë njëra-tjetrës një person si bashkëkoordinues, për mbajtjen e komunikimit midis tyre, shkëmbimin e informacionit dhe përgatitjeve të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshje.
2. Palët caktojnë grupet e përbashkëta të punës për hartimin dhe formalizimin e projekteve me interes të përbashkët dhe profesional.

**Neni 10**  
**Dispozita të fundit**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga Palët.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe lidhet për një afat kohor të papërcaktuar.
3. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të njëjtë në gjuhën shqipe, 2 (dy) për Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it dhe 2 (dy) për Prokurorinë e Përgjithshme.

**PËR**

**AGJENCINË KOMBËTARE TË  
KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Prof. Ass Linda PUSTINA



**PËR**

**PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

**PROKURORI I PËRGJITHSHEM**

Olsian ÇELA

